

Lutjes për lëshimin ose vazhdimin e lejes për qëndrim të përkohshëm për anëtarin e familjes të hulumtuesit duhet bashkëlidhur:

- fotografinë e të huajit ose numrin referues nga deponimi elektronik i fotografive;
 - pasaportën ose fotokopjen e verifikuar të pasaportës së të huajit;
 - dëshminë për sigurimin shëndetësor adekuat, i cili mbulon së paku shërbimet shëndetësore emergjente në Republikën e Sllovenisë, kur i huaji thekson, se në Republikën e Sllovenisë nuk posedon sigurimin e detyrueshëm shëndetësor;
 - dëshminë për mjete të mjaftueshme për mbijetesë;
 - vërtetimin nga evidenca penale të shtetit amë të huajt gjithmonë në rastin e lutjes për lëshimin e lejes së parë, kurse në rastet tjera, nëse organi kështu kërkon;
 - dëshmitë mbi marrëdhënien familjare, nëse faktet amzë nuk janë të regjistruar në regjistrin amzë në Republikën e Sllovenisë.

Në procedurën njësia administrative sipas detyrës zyrtare do ti siguroi të dhënat në vijim:

- nga regjistri amzë i Republikës së Sllovenisë mbi lindjen ose lidhjes martesore të të huajit në territorin e Republikës së Sllovenisë, përkatësisht për faktet tjera amzë, nëse janë të shënuara në regjistrin amzë të Republikës së Sllovenisë;
 - mbi sigurimin e detyrueshëm shëndetësor në Republikën e Sllovenisë, kur i huaji me rastin e dëshmimit të sigurimit shëndetësor thekson, se në Republikën e Sllovenisë ka sigurimin e detyruar shëndetësor;
 - nga evidenca penale, evidenca e aktgjykimeve të plotfuqishme përkatësisht aktvendimeve për kundërvajtjet, të cilat në Republikën e Sllovenisë i mbanë Ministria e drejtësisë;
 - nga evidencat për vendimet e plotfuqishme të kundërvajtjeve, të cilat i mbajnë organet për kundërvajtje në Republikën e Sllovenisë;
 - mbi aktakuzat e plotfuqishme të depozituara dhe aktgjykimet e jo plotfuqishme të lëshuara, të cilat i mbanë gjykata kompetente;
 - nga evidencat, të cilat i mban organi tatimore mbi detyrimet tatimore të jopaguara të skaduara dhe mbi kundërvajtjet tatimore, të cilat janë të shënuara si sekret tatimor.

Informata lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale:

- tē dhënat personale nga formulari për qëllim tē lëshimit tē lejes për qëndrim përpunohen në ujdi me nenin 93. tē Ligjit për tē huajt;
 - organi ka tē drejtë që tē përfitoi edhe tē dhëna tjera, nëse kjo është nē interesin tuaj dhe se pēr këtë e keni dhënë pëlqimin ose nëse kjo është e lejuar me ligj, pëlqimin mund ta revokoni kurdoherë pranë organit;
 - nëse pēr këtë janë plotësuar kushtet e parashkruara, keni tē drejtë ndaj informimit me tē dhënat tuaja personale, tē drejtën ndaj përkufizimit tē përpunimit dhe tē drejtën ndaj kundërshtimet tē përpunimit;
 - keni tē drejtë që tē verifikoni saktësinë e tē dhënavë tuaja personale, tē shënuara nē lejen pēr qëndrim, dhe tē drejtën që tē kërkoni ndryshimin e tyre ose, nëse pēr këtë janë tē plotësuara kushtet e parashkruara, fshirjen e tyre;
 - menaxhuesi i ruan tē dhënat tuaja nē ujdi me nenin 115. tē Ligjit pēr tē huajt;
 - kontakti i personit tē autorizuar tē menaxhuesit pēr mbrojtjen e tē dhënavë personale nē Ministrinë e punëve tē brendshme: posta elektronike: dpo.mnz@gov.si;
 - nëse jeni tē mendimit, se tē dhënat tuaja po përpunohen joliqishëm, mund tē ushtroni

ankesë pranë Autorizuesit të informimit.